

Demokraci Plus (D+) në këtë raport ka analizuar shumat e shpenzuara të parasë publike përmes kontratave për publikim dhe reklamim në media.

Cak i këtij hulumtimi janë të gjitha ministrinë, të gjitha komunat, Kuvendi, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit. Po ashtu pjesë e këtij raporti janë edhe disa nga ndërmarrjet kryesore publike, si: Telekom i Kosovës (TK), Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) dhe Posta e Kosovës (Posta).

Ky raport përmban informata lidhur me mënyrën e lidhjes së këtyre kontratave dhe analizë lidhur me nevojën e institucioneve që të lidhin kontrata të tilla me mediat. Qëllimi i këtij hulumtimi është vënia në pah e çfarëdo ndikimi që këto kontrata mund të kenë në politikën redaktoriale, në raportimin e drejtë të mediave për punën dhe aktivitetet e institucioneve në raport me përgjegjësitë e tyre.

Po ashtu, D+ përmes këtij raporti ka testuar transparencën e institucioneve publike dhe të vet mediave, sa i përket gatishmërisë së tyre për të ofruar informata në raport me kontratat që kanë lidhur këto dy palë dhe qëllimet për të cilat janë lidhur.